



Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

Botimi për muajin korrik 2024

jetojmë më mirë së bashku

Mbroni atë që mund
të mbroni vetë

**Sigurimi
i Shtëpisë
te SIGAL
UNIQA**



PËRMBAJTJA

Pensionet private / Ponari: Shqiptarët po investojnë për të pleqëruar me dinjitet

Reja nën mbrojtjen e SIGAL UNIQA / Kompania lider siguron instalacionin e famshëm në zemër të Tiranës

fpchealth-SIGAL UNIQA revolucionarizon mënyrën e trajtimit të dëmeve shëndetësore tashmë gjithë nga celulari juaj

Super mbrojtje / Pushimet në Shqipëri më të sigurta me SIGAL UNIQA

Karton jeshil + Asistencë rrugore / Shëtit botën pa shqetësime me SIGAL UNIQA

Raporti i amf/Grup SIGAL UNIQA lider i sigurimeve në Shqipëri edhe për 6-mujorin e parë 2024

Raporti i BQK / SIGAL UNIQA lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

Maqedoni-e-Veriut /Antovska: Rritje e policave në sigurimet e jetës në rritje edhe dëmet e paguara

Uniqa Sustainable Business Solutions / Zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për kompanitë

Video, jetojmë më mirë së bashku/Mbi 5800 nxënës pjesë e UNIQA Trend Sport Festival

jetojmë më mirë së bashku


SIGAL UNIQA Group Austria është sot një kompani me standarte tërësisht europiane, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërben atyre me të cilët ne shkëmbehem në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirëmëngjes, atyre me të cilët ndajmë jetën në qytet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme.

Çdo ditë SIGAL UNIQA punon, rritet, ecën përpara, zgjeron partnerët, stafi n me qëllimin e vetëm: ofrimin e një shërbimi sa më profesional ndaj klientëve që jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat ia besojnë pikërisht kësaj kompanie. Sepse çdo klient i SIGAL UNIQA, i vogël apo i madh, është pjesë e një familjeje të madhe që sot numëron mbi 1 milion anëtarë.



Kryej një check up edhe pas të 70^{ve}

Paketa e Kujdesit
Shëndetësor nga
SIGAL UNIQA
PA LIMIT MOSHE





rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore

Pensionet private/ Ponari: Shqiptarët po investojnë për të “pleqëruar me dinjitet”



Pasiguritë ekonomike bashkë me plakjen e shpejtë të popullsisë nga njëra anë, shtuar dhe faktin se ajo që të moshuarit në vend marrin nuk mjafton, po i shtyn qytetarët drejt skemave private të pensioneve.

Nga pak më shumë se 38 mijë fundvitin e shkuar, numri i atyre që kontribuojnë vullnetarisht arriti në gati 40 mijë në fund të marsit.

“Ligji i fundit për rregullimin e skemës së pensioneve private vullnetare ka bërë të mundur dhe ka krijuar disa incentiva për disa punonjës që futen në këto skema. Nga ana tjetër, ligji ka krijuar edhe lehtësi të punëmarrësit që të bëjë një pjesë të zbritshme nga paga e punonjësve. Kjo ka bërë që të rritet numri i të interesuarve”, thotë për A2 CNN Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se vlera e parave të i

nvestuara në skemat private të pensioneve në fund të marsit arriti në 6.8 miliardë lekë duke u zgjeruar me 5.4% në raport me fundvitin e shkuar.

Po a ja vlen investimi në skemat private dhe sa mund të jetë vlera e pensionit që i moshuari do të marrë kur të arrijë moshën? “Nis nga 30-40, 50 apo edhe 70 mijë lekë nga skema vullnetare private dhe 20-30 mijë lekë nga ajo publike. Në fund, ai që del në pension merr rreth 1 milionë lekë të vjetra në muaj”, vijon Ponari.

Ponari thekson edhe nevojën për më shumë ndërgjegjësim tek qytetarët.

“Duhet nisur me ndërgjegjësimin. Si çdo gjë e re edhe skema private vullnetare e pensioneve paragjykohet. Duhet të mësohemi mos paragjykojmë gjithçka.”



Ku ka art është SIGAL UNIQA

“Reja” nën mbrojtjen e SIGAL UNIQA/ Kompania lider siguron instalacionin e famshëm në zemër të Tiranës

Një nga veprat më të njohura të instalacionit të artit publik, “Reja”, ideuar nga artisti i mirënjohur japonez Sou Fujimoto, qëndron prej disa vitesh në zemër të Tiranës, përpara Galerisë së Arteve duke u shndërruar në një ambient kulturor, me aktivitete të shumta për publikun.

Vepra e mirënjohur, e cila ka qëndruar edhe në Galerinë “Serpentine” në Londër, nuk është thjesht një metaforë e motit por një vepër e mirëfilltë arti.

Dhe ku ka art sigurisht që nuk mund të mungonte kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria.

Kompania, e njohur jo vetëm për produktet më novatore të sigurimit dhe mbi 500 milionë euro dëmshpërblime në 25 vjet, është një mbështetëse e fuqishme e artit dhe kulturës. Për këtë arsye, “Reja” është marrë në sigurim nga SIGAL UNIQA, si një garanci se instalacioni në fjalë është i sigurtë nga çdo ngjarje e papritur që mund ta dëmtojë atë.

“SIGAL UNIQA Group Austria është shoqëria më e madhe e sigurimit në Shqipëri dhe do të jetë një nga sponsorët gjeneralë, që do të kujdeset për sigurimin e pavionit dhe programin e aktiviteteve publike”, shkruan Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit në websiten e saj.

Kjo është një tjetër dhuratë që SIGAL UNIQA i bën kryeqytetit teksa më herët ka sponsorizuar aktivitete të ndryshme dhe ka ndërtuar fusha sportive.

SIGAL UNIQA zotohet se sponsorizime të tilla në art, kulturë, sport do të vijojnë edhe në të ardhmen pasi kompania beson fort se me art, kulturë e sport jetohet më mirë.

“fpcHealth” / SIGAL UNIQA revolucionarizon mënyrën e trajtimit të dëmeve shëndetësore. Tashmë gjithçka nga celulari juaj



Risia, inovacioni dhe përshtatja me hapat e zhvillimit teknologjik.

Këto janë disa prej tipareve kryesore që e bëjnë SIGAL UNIQA Group Austria-ndryshe nga kompanitë e tjera të sigurimit dhe një prej arsyeve primare pse vazhdon të jetë lidere në treg edhe pse kanë kaluar mbi 25 vjet nga themelimi.

Pasi solli për herë të parë në Shqipëri Sigurimin Privat të Shëndetit, të cilin e kryeson shumë bindshëm krahasuar me “simotrat” e saj, SIGAL UNIQA lançon edhe aplikacionin e ri të dëmeve të shëndetit nga SIGAL UNIQA, “fpcHealth”.

Një zhvillim inovativ që do të revolucionarizojë mënyrën se si klientët që kanë një policë sigurimi shëndeti pranë SIGAL UNIQA të mund të menaxhojnë sa më mirë dhe më thjeshtë sigurimin e tyre.

“fpcHealth” përputhet me standardet e larta të teknologjisë dhe sigurisë duke synuar një mjedis dixhital të dizajnuar për të lehtësuar procesin e paraqitjes dhe procesimin të dëmeve shëndetësore.

Si funksionon aplikacioni

Aplikacioni mund të shkarkohet FALAS si në celularët androidë ashtu edhe ata apple.

Për të vijuar me regjistrimin, çdo informacion i nevojshëm është i disponueshëm në PlayStore dhe APPStore.

- Android
https://play.google.com/store/apps/details?id=sigal.fpc&hl=en_US
- Apple
<https://apps.apple.com/al/app/fpchealth/id6450365482>

Si të regjistroheni

- Hapni aplikacionin dhe zgjidhni “Regjistrohu”
- Vendosi të dhënat e Nr.personal të kartës tuaj te identitetit i cili fillon dhe mbaron me shkronjë. (shembull: lxxxxxxxK)
- Krijoni fjalëkalimin tuaj.
- Vendosi emrin, mbiemrin, atësinë dhe adresën tuaj të e-mailit.
- Pas regjistrimit do duhet të bëni verifikim e kartave tuaja aktive në seksionin Profili im, “Kartat e mia”.

Si të kryeni verifikimin e kartave tuaja?

- Duke klikuar tek “Verifiko kartën” do t’ju shfaqet një tabelë ku do t’ju kërkojë të vendosni të dhëna nga karta juaj.
- Vetëm pasi keni verifikuar kartën tuaj, ju mund të kryeni aplikime për rimbursim të faturave tuaja apo të bëni një kërkesë për garanci pagese.

Çfarë ofron aplikacioni

- Karta elektronike
- Menaxhim dhe monitorim i dëmeve shëndetësore në kohë reale
- Kërkesë për rimbursim
- Garanci pagese
- Arkivë digjitale


Kujt i shërben ky aplikacion?

Kujtdo që disponon një kartë shëndeti SIGAL UNIQA, mbi moshën 18 vjeç.

Për fëmijët nën 18 vjeç që disponojnë sigurim shëndetësor, menaxhimi i tij do të administrohet nga njëri prej prindërve.

Raporti i AMF/ Grupi “SIGAL UNIQA”, lider i sigurimeve në Shqipëri edhe për 6-mujorin e parë 2024

Ndarja e Tregut të Sigurimeve të Jo-Jetës Qershor 2024



SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.


Sipas raportit më të fundit nga AME, mbi ecurinë e tregut të sigurimeve për 6-mujorin e parë 2024, SIGAL UNIQA dominon tregun si në sigurimet e Jo-Jetës, në ato të Jetës dhe në sigurimet e detyrueshme dhe vullnetare.

Në Sigurimet e Jo-Jetës, klasa që dominon tregun me 91.3%, kompania shqiptaro-austriake zë 28% të tij, ndërsa është i pari edhe në dëmet e paguara me 23.5% të totalit nga 8 kompani gjithësej.

Edhe në Sigurimet e Jetës, SIGAL LIFE UNIQA mbetet preferenca numër 1 e qytetarëve dhe bizneseve teksa zë mbi 40% të tregut ku aktualisht operojnë 4 kompani

Në dëmet e paguara, SIGAL LIFE UNIQA zë 47.17% të totalit duke u rënditur sërish e para.

Ndarja e Tregut të Sigurimet e Jetës Qershor 2024



Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar për SIGAL UNIQA zënë 38.27% të totalit dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 21.12% të totalit të tregut.

- Në SIGURIMET E JETËS, duke zotëruar 40.05% të tregut
- Në SIGURIMET E JO JETËS, duke zotëruar 27.77% të tregut
- Në SIGURIMIN MOTORIK, duke zotëruar 20.87% të tregut
- Në SIGURIMIN E PASURISË, duke zotëruar 46.87% të tregut
- Në SIGURIMIN E AKSIDENTEVE DHE TË SHËNDETIT, duke zotëruar 49.86% të tregut
- Në SIGURIMIN PRIVAT TË SHËNDETIT duke zotëruar 44.62% të tregut
- Në SIGURIMIN SHËNDET NË UDHËTIM duke zotëruar 79.30% të tregut

Në total, në Sigurimet e Jo-Jetës dhe Jetës, ku operojnë 12 kompani, SIGAL UNIQA zë 29% të totalit të tregut.

Super mbrojtje për makinën tuaj

Sigurimi Kufitar + Minikasko + AutoSOS

Bli nga celulari sigurimin që i duhet makinës tuaj për të udhëtuar plotësisht i mbrojtur nga çdo e papritur në Shqipëri.



AutoSOS
+ MiniKasko
50 euro



Je turist i huaj apo emigrant që pushimet e verës do ti kalosh në Shqipëri?

Do të vish me automjetin tënd por i frikësohesh fluksit të madh në rrugë dhe problemeve të shumta që mund t'ju pengojnë të shijoni ditët tuaja më të bukura? Tani nuk keni pse shqetësoheni më!

SIGAL UNIQA vjen me mundësi unike, të cilat ju mundësojnë qëndrim të qetë dhe të sigurt në Shqipëri.

Kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve ofron mundësinë e blerjes së kombinuar të siguracionit të detyrueshëm **“Polica Kufitare” me Shërbimin e Asistencës Rrugore “AutoSOS” dhe ose me “MiniKasko”** për të qenë të mbrojtur financiarisht nga çdo e papritur gjatë udhëtimit tuaj.

Çfarë është **“SIGAL UNIQA AutoSOS”**?

“SIGAL UNIQA AutoSOS” është shërbimi asistencës rrugore, i pari dhe i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe rajon, që gjendet pranë jush në rast pamundësie për të lëvizur automjetin tuaj, qoftë një rënie e baterisë apo e gomës, mbarimit të karburantit, një defekti teknik apo përfshirjes në një aksident.

Çfarë ofron ky shërbim?

“SIGAL UNIQA AutoSOS” me mbulim Shqipërinë mundëson:

- Qendër kontakti 24 orë të ditës në 7 ditë të javës
- Riparim në vend i automjetit
- Shërbim Karroatreci

Çfarë është **“MiniKasko”**?

“MiniKasko” është sigurimi që mbulon dëmet e shkaktuara mjetit tuaj në rast përplasje me një mjet tjetër në rrugë dhe në lëvizje, pavarësisht se kush është fajtori i aksidentit.

Zona e Mbulimit: Territori i Republikës së Shqipërisë


Kohëzgjatja e sigurimit: Sipas kohë së qëndrimit, deri në 1 vit dhe vetëm për një ngjarje të ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Blini ONLINE paketat më të mira në treg direkt nga celulari juaj dhe mos e vrisni mendjen për të papriturat që mund të hasni në rrugët e Shqipërisë, rajonit apo Europës.

• **“Kufitare + AutoSOS/ MiniKasko”:**
<https://sales.sigal.com.al/OnLineInsurancePolicy/SelfService/KF/KufitareOnline.aspx>

Shëtiti botën pa shqetësime me SIGAL UNIQA

Bli Online sigurimin e makinës Kartoni Jeshil plus shërbimin e asistencës rrugore SIGAL UNIQA AutoSOS



Vera është stina e pushimeve, udhëtimeve dhe zbulimit të destinacioneve të reja.

Falë lehtësisë së lëvizjes brenda zonës Schengen ka bërë që vit pas viti numri i shqiptarëve që zgjedhin të pushojnë jashtë Shqipërisë të jetë gjithmonë e në rritje. Madje edhe i atyre që zgjedhin të udhëtojnë me makinën e tyre.

Të gjithë e dimë se, çdo automjet me targa shqiptare, e ka të detyrueshëm pajisjes me Sigurimin “Karton Jeshil” sa herë që del jashtë Republikës së Shqipërisë, përjashtuar Kosovën.

Përse të zgjedhim “Kartonin Jeshil” nga SIGAL UNIQA?

– SIGAL UNIQA ofron komoditetin e blerjes online, në çdo moment, kudo ndodheni. Mjafton të keni internet në celularin tuaj.

– SIGAL UNIQA është e vetmja kompani që ofron falas asistencën juridike kur klientët e saj që janë përfitues në një aksident.

– SIGAL UNIQA ofron edhe mundësinë që, bahkë me “Kartonin Jeshil” të keni gjatë

udhëtimeve tuaja edhe shërbimin e Asistencës Rrugore “SIGAL UNIQA AutoSOS”, e vetmja e këtij lloji në Shqipëri.

“SIGAL UNIQA AutoSOS” me mbulim rajonin dhe Evropën mundëson:

- Qendër kontakti 24 orë të ditës në 7 ditë të javës
- Riparim në vend i automjetit
- Shërbim Karroatreci
- Zëvendësim i automjetit në rast aksidenti
- Parkim
- Akomodimi në hotel
- Riatdhesim me tren / avion ose udhëtim drejt destinacionit tuaj
- Shërbim Taxi

Blini ONLINE tani paketën më të mirë në treg, direkt nga celulari juaj, dhe mos e vrisni mendjen për të papriturat që mund të hasni në rrugët e rajonit apo Europës.

“Karton Jeshil + AutoSOS”

<https://sales.sigal.com.al/OnLineInsurancePolicy/SelfService/KJ/KartonJeshilOnline.aspx>

SIGAL UNIQA Group Austria ka nisur fushatën e saj të informimit të qytetarëve në të gjithë vendin!

Kjo fushatë ka filluar tashmë në qytetin e Pogradecit, Fierit, Shëngjinit, Gjirokastrës, Durrësit, Beratit, Shkodrës, Velipojës dhe Kavajës, dhe do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Ne jemi të përkushtuar për të ofruar informacion të qartë dhe të dobishëm për të gjithë qytetarët tanë.


Qëndroni të informuar dhe bashkohuni me ne në këtë nismë për të përmirësuar komunikimin dhe shërbimet për komunitetin tonë!

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku!



Raporti i BQK/ SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

Janar-Qershor 2024



Pak ditë pasi Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare në Shqipëri, përmes raportit për periudhën janar-qershor 2024, na tregoi se SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për SIGAL UNIQA në Kosovë.

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), publikuar ditën e sotme, SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve duke zënë mbi 15% të një tregu ku operojnë 10 kompani.

“Gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, kompania arriti të realizojë 15.36% të të gjitha primeve të shkruara në sektorin e Sigurimeve të Jo-Jetës. Kjo arritje thekson praninë dhe përkushtimin tonë për të ofruar shërbime të jashtëzakonshme për klientët tanë”, shkruan SIGAL UNIQA Kosovë në postimin e saj.

RAPORTI I PLOTË

<https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare-2/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/>

Maqedoni e Veriut, Antovska: Rritje e policave në Sigurimet e Jetës. Në rritje edhe dëmet e paguara



“Tregu i sigurimeve është i qëndrueshëm dhe në rritje të vazhdueshme, dhe këtë mund ta konfirmojmë përmes shifrave”.

Kështu shprehet në një intervistë për “Bloomberg Adria” Aleksandra Shkempi Antovska, CEO e “UNIQA LIFE” dhe njëherazi nënkryetare e Grupit të Sigurimeve pranë Dhomës Ekonomike.

Sipas saj, rritja e tregut shihet në të gjitha klasat e sigurimit por kryesisht në ato të Jetës ku edhe dëmet e paguara kanë ardhur në rritje.

“Trendi i rritjes është i pranishëm, dhe kjo në të gjitha klasat e sigurimeve, por më e theksuar është rritja e numrit të policave të reja në kompanitë e sigurimeve të Jetës ku edhe numri i dëmeve të paguara ka ardhur në rritje”, thotë Antovska.

UNIQA në Maqedoninë e Veriut

“UNIQA Shkup”, pjesë e SIGAL UNIQA Group Austria, prej afro 20 vitesh në tregun maqedonas të sigurimeve, ka shënuar suksese të jashtëzakonshëm ndërsa ka ditur t’ju shërbejë klientëve mirë, t’ju japë produktin e nevojshëm që ata duan.

Kompania ka qenë gjithmonë afër klientëve edhe atëherë kur ata kanë më shumë nevojë, në pagimin e dëmeve.

“UNIQA” në Maqedoninë e Veriut ka ditur gjithashtu të jetë edhe pranë komunitetit me aktivitete të ndryshme ku ka marrë pjesë ose ka sponsorizuar.

“UNIQA Sustainable Business Solutions” / Zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për kompanitë



About us

Risk Engineering

Climate Resilience

Contact us

DE | EN



What Sets Us Apart



Industry Expertise

Leveraging decades of experience from the insurance industry, our experts identify typical risk situations specific to your industry, enabling proactive risk management strategies.



Loss Prevention

We believe in the power of anticipation. By evaluating potential dangers in advance, we equip you with robust strategies to mitigate risks effectively.



Tailored Risk Analysis

Working with our experienced property risk engineers not only lowers operating costs but also enhances your business's resilience. Our data-driven approach enables better capital decisions that are aligned with your risk tolerance and your needs.



Risk Minimization

Through tailored security concepts, we design and implement measures to effectively reduce risks, ensuring the resilience of your business.

“UNIQA INSURANCE Group” forcon ofertën e saj për klientët e korporatave me një segment të ri biznesi.

Me një volum kumulativ biznesi prej mbi dy miliardë euro prime, UNIQA është një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në segmentin B2B në Austri dhe Evropën Qëndrore dhe Lindore.

Duke u mbështetur në ekspertizën e saj mbi 200-vjeçare, UNIQA hedh një hap më tej përtej biznesit klasik të sigurimeve: “UNIQA Sustainable Business Solutions”.

Kjo e fundit mbështet kompanitë individuale dhe ato të mëdha në forcimin e qëndrueshmërisë së tyre me menaxhimin aktiv të rrezikut dhe sjelljen e strategjive të tyre të qëndrueshmërisë në përputhje me kushtet e kuadrit ligjor.

Nga 1 korriku, kompania do të jetë fillimisht aktive në Austri, Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovakia, ndërsa më pas do të pasojë edhe në shtete të tjera ku “UNIQA” operon.

Vlerësim i avancuar i rrezikut në mjedise komplekse



Kompanitë përballen me një mjedis biznesi gjithnjë e më kompleks – nga kërkesat rregullatore të qëndrueshmërisë deri te rreziqet në rritje nga ndryshimet klimatike dhe sfidat gjeopolitike.

Kjo është arsyeja pse UNIQA Sustainable Business Solutions shtrin parandalimin e humbjeve përtej zgjidhjeve tradicionale të sigurimit dhe ndihmon kompanitë të eliminojnë në mënyrë proaktive rreziqet e mundshme dhe të minimizojnë rreziqet. Ai mbështet nevojat e transformimit të bazuara në ESG me analiza dhe rekomandime për zgjidhje të qëndrueshme në kuptimin e një perspektive holistik 360 gradë për klientët.

“Për ne, integrimi i UNIQA Sustainable Business Solutions është një pasojë e qartë e strategjisë me në qendër klientin që ne kemi zbatuar me sukses në të gjithë grupin që nga viti 2020. Një avantazh i madh për klientët tanë është ekspertiza e kombinuar e inxhinierisë së rrezikut dhe ndërveprimi i mendjeve më të mira nga 17 tregjet tona në Evropë”, shpjegon Wolfgang Kindl, Anëtar Bordi për Customer & Market International.

Peter Humer, Anëtar i Bordit për Customer & Market Austria, shton:

“Nëse nevojat e klientëve tanë ndryshojnë, ne duam të jemi në anën e tyre si një partner i barabartë – përtej kufijve kombëtarë dhe shërbimeve tradicionale të sigurimit. Me UNIQA Sustainable Business Solutions, ne jemi një partner i besueshëm për klientët tanë të korporatave në proceset shpesh sfiduese të transformimit.”

Mbrojtja e klimës për një të ardhme të suksesshme

Me kompaninë e re, UNIQA po merr parasysh përgjegjësinë e saj ndaj shoqërisë – e vërtetë ndaj premtimit të markës për të jetuar më mirë së bashku.

Si një kompani sigurimesh, UNIQA i njeh rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe përpiqet t'i kundërshtojë ato në planin afatgjatë.

“Veçanërisht në një kohë të karakterizuar nga presioni rregullator në rritje dhe efektet e ndryshimeve klimatike, masat parandaluese dhe një strategji e fuqishme e menaxhimit të rrezikut janë vendimtare për suksesin e kompanisë,” theksojnë Olivera Böhm-Rybak dhe Christoph Kapfinger, Drejtor Menaxhues i UNIQA Sustainable Business Solutions në Austri: “Qëllimi ynë është të jemi një partner i fortë për klientët tanë, duke i mbështetur ata në rrugën e tyre drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe të suksesshme.”

Më shumë informacione: www.uniqa-sustainable.com

VIDEO – “Jetojmë më mirë së bashku”/ Mbi 5,800 nxënës pjesë e “UNIQA Trendsportfestival”



Më shumë se 5,850 nxënës ishin pjesë e “UNIQA Trendsportfestival”, i organizuar nga “UNIQA Insurance Group” në të gjithë Austrinë ku për herë të parë këtë vit morën pjesë edhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Përmes sporteve të ndryshme, mbi 65 sporte të tillë, “UNIQA” kërkon të përçojë mesazhin e saj “Jetojmë më mirë së bashku”, çka është edhe motoja e Grupit në 17 shtete të ndryshme të Europës.

“UNIQA, si kompania lider e sigurimeve shëndetësore në Austri, ju këshillon, shoqëron dhe mbështet në rrugën drejt një jete më të mirë. Të ushtrohesh dhe të bësh sport rregullisht është një faktor vendimtar për të qëndruar të shëndetshëm. Çdo vit, festivali frymëzon mijëra studentë në të gjithë Austrinë”, shprehet ndër të tjera Peter Humer, anëtar i Bordit të UNIQA për Customer & Market Austria.

“UNIQA Insurance Group” është një prej kompanive lider të sigurimeve në Austri dhe Evropë dhe daton prej vitit të largët 1811 kur u themelua “Salzburger Landes-Versicherung”.

Sot, “UNIQA Insurance Group” mban emrin e saj në rangun e lartë të industrisë së sigurimeve, me një shtrirje në 17 shtete ku operon përmes 40 kompanive.

Sipas studimeve të pavarura, “UNIQA Insurance Group” është prej shumë vitesh marka më e njohur dhe më e besueshme e sigurimeve në Austri.


Ajo numëron mbi 22,500 punonjës, mbi 17 milionë klientë në 17 shtete të ndryshme dhe rreth 7.2 miliardë prime vjetore.

Prej marsit 2007 ajo është pjesë e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes GRUPIT “SIGAL UNIQA”.



MAKINA PERFЕКTE MBROJTJA PERFЕКTE UDHËTIMI PERFЕKT

Sigurim ditor Kasko dhe AutoSOS
për të gjitha automjetet në Rentout.





COPYRIGHT SIGAL UNQA 2024

Përmbajtja e këtij newsletter dhe të gjitha të drejtat e saj i përkasin kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria dhe përdorimi nga të tretë, pa autorizimin e SIGAL UNIQA nuk është e lejuar. Shpërndarja e këtij newsletter mund të bëhet vetëm nëpërmjet kanaleve zyrtare të kompanisë.